



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr. 203/2025
Datë: 21.08.2025

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 64, paragrafi 1, nënparagrafi, 1.5, nenin 68, paragrafi, 1, nenin 69, nenin 71, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.6, neni 92, paragrafi 1, nënparagrafin 1.1, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenin 13, (paragrafi 3, nënparagrafi 3.1) të Rregullores Nr.04/2022 për Procedurën e Brendshme për Shqyrtimin e Ankesave për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të ankesës me nr. protokolli 407, të parashtruar nga subjekti i të dhënave znj. A.A, ndaj kontrolluesit Autoritetit të Konkurrencës, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër të protokollit 407, e datës 16.04.2025, e parashtruar nga subjekti i të dhënave A.A, ndaj Autoritetit të Konkurrencës, në cilësinë e kontrolluesit.
2. **Shqiptohet** gjobë në vlerë prej **20,000.00 € (njëzetmijë euro)**, ndaj Autoritetit të Konkurrencës, në cilësinë e kontrolluesit, me adresë: Rr. Migjeni kati VI, ish objekti i “Bankës së Lublanës”, Prishtinë, për shkak të përpunimit (ofrimit) të të dhënave personale pa bazë ligjore.
3. **Obligohet** kontrolluesi që përpunimin e të dhënave personale, ta bëjë në harmoni me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. **Obligohet** kontrolluesi, që shumën e përcaktuar nga pika 2 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhirollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
5. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbaruesi Privat.

6. **Obligohet** kontrolluesi, që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të vendimit.

A r s y e t i m

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 16.04.2025, ka pranuar përmes postës elektronike (e-mail) ankesën me nr. protokolli 407, të paraqitur nga subjekti i të dhënave personale, A.A, e cila pretendon se të dhënat personale të saj po i përpunohen në mënyrë të paautorizuar dhe jo-proporcionale përmes sistemit të vëzhgimit me kamerë nga Autoriteti i Konkurrencës. Në ankesë e sajë, pala ankuese ka sqaruar se është nën monitorim të vazhdueshëm, dhe se të gjitha të dhënat mbi lëvizjet e saj (hyrjet dhe daljet nga objekti) i përcillen në formë të shkruar drejtorit të institucionit nga zyrtari i IT-së, ndonëse ky i fundit, në kohën e raportimit, nuk ka pasur rol apo autorizim si person përgjegjës për mbikëqyrjen e sistemit të vëzhgimit me kamera. Gjithashtu, ankuesi/ja ka shprehur dyshime se kamerat kryejnë edhe regjistrim të zërit.

Përveç kësaj, ankuesi/ja në ankesën e sajë ka shpreh shqetësimin se pamjet e marra nga kamerat e sigurisë në objektin e punës, ku ajo paraqitet, janë shpërndarë nga punëdhënësi tek personat e tretë konkretisht tek Betimi për Drejtësi. Këto pamje nga Betimi për Drejtësi janë përdorur dhe publikuar në një artikull mediatik në lidhje me një rast për të cilin ankuesi/ja nuk ka asnjë lidhje – as si person i përfshirë, as si palë e interesuar.

Ankuesi/ja vlerëson se publikimi i pamjeve në këtë kontekst ka cenuar rëndë dinjitetin, reputacionin dhe privatësinë e saj, duke krijuar gjithashtu një perceptim të rremë në opinionin publik për përfshirjen e saj në rastin e publikuar.

Së bashku me ankesën, subjekti i të dhënave ankuesi ka bashkangjitur edhe disa mbishkrime si provë lidhur me pretendimin e saj rreth monitorimit mbi lëvizjet e sajë, si dhe linkun në të cilën janë publikuar të dhënat të cilat deklarohen se janë shpërndarë nga Autoriteti i Konkurrencës. (Linku: https://betimiperdrejtesi.com/betimi-per-drejttesi-403-provat-qe-nuk-u-pane-kur-drejtesia-zgjedh-ane/****)

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, dhe nenin 69, të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia përmes zyrtarëve të inspektimit, ka filluar procedurën e shqyrtimit të ankesës për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Në fazën fillestare, zyrtari i inspektimit ka shqyrtuar provat e bashkangjitura. Nga përmbajtja e mbishkrimeve nuk mund të konstatohet se subjekti i të dhënave është monitoruar për lëvizjet e saj, pasi ato nuk përmbajnë emrin e saj dhe rrjedhimisht nuk dëshmojnë se ajo ka qenë nën vëzhgim përmes sistemit të kamerave.

Tutje, është shqyrtuar edhe linku i bashkangjitur nga ankuesi/ja. Nga ekzaminimi rezulton se “Betimi për Drejtësi” ka publikuar një video me titull “*Provat që nuk u ‘panë’, kur drejtësia zgjedh anë*”, në të cilën, në minutën ****, shfaqet imazhi i subjektit të të dhënave. Ky imazh është marrë nga pamjet e sistemit të vëzhgimit me kamerë, i cili administrohet nga Autoriteti i Konkurrencës. Sipas të dhënave që gjenden në këtë video, koha në të cilën pala ankuese paraqitet është në ora *** min, datë 20.03.2024.

Me qëllim të shqyrtimit të mëtutjeshëm të ankesës, zyrtarët e inspektimit, më datë 22.07.2025, kanë realizuar inspektim në Autoritetin e Konkurrencës në prezencën e drejtorit të autoritetit dhe personit përgjegjës për monitorimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë, me ç’ rast në bazë të gjendjes faktike është hartuar procesverballi Nr. 14/2025, me numër serik: 0000172, në të cilin është konstatuar kjo gjendje: Kamaret e vendosura në autoritetin e Konkurrencës nuk bëjnë regjistrimin e zërit. Sipas deklaratës së drejtorit të përgjithshëm qasja në pamjet e kamerave nuk i është dhënë “Betimit për Drejtësi” i cili ka publikuar materialin. Këto pamje i janë dorëzuar policisë në formë të USB-së, për rastin e mëparshëm “Hyrje e paautorizuar në objekt nga palët pas orarit të rregullt të punës”. Autoriteti i Konkurrencës ka të përcaktuar me vendim zyrtarin përgjegjës për monitorimin e sistemit të vëzhgimit me kamerë.

LMDhP në nenin 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, ka dhënë përkufizimi i shprehjes ‘kontrollues i të dhënave’, me të cilin nënkuptohet se kontrollues i të dhënave është çdo person fizik apo juridik nga sektori publik ose privat që individualisht ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale. Andaj, sipas këtij përkufizimi, “Autoriteti i Konkurrencës”, cilësohet kontrollues i të dhënave.

LMDhP, përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. Sipas nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të LMDhP-së, me të dhëna personale nënkuptohet çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”); një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejtë ose jo drejtpërdrejtë, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues *online*, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik. Në kuptimin e kësaj dispozite, imazhi i fytyrës përmes së cilit identifikohet subjekti i të dhënave konsiderohet e dhënë personale dhe përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

Kur kemi të bëjmë me përpunimin e të dhënave personale, ligji, në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me **përpunim** nënkuptohet çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi. Në kuadër të kësaj dispozite, nënkuptojmë se shpërndarja apo ofrimi i të dhënave, përbënë përpunim të të dhënave personale dhe si i tillë, ky përpunim duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme.

LMDhP, në nenin 4, ka përcaktuar parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale që duhet respektohet me rastin e përpunimit të të dhënave personale, siç janë parimi i ligjshmërisë, parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i saktësisë, parimi i kufizimit të ruajtjes, parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit dhe në fund parimi i llogaridhënies, i cili përcakton se kontrolluesi duhet të jetë përgjegjës dhe në gjendje të zbatoj përputhshmërinë e të gjitha parimeve të përcaktuara si më lartë.

Parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës përcakton se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Parimi i ligjshmërisë, është një parim i rëndësie të veçantë për çështjen e bazës ligjore, pasi është një nga përbërësit kryesorë të nevojshëm që përpunimi të jetë i ligjshëm. Transparenca, nënkupton se kontrolluesi duhet gjithashtu t'u ofrojë subjekteve të të dhënave personale informacion të qartë dhe transparent në lidhje me qëllimin ose qëllimet e përpunimit të të dhënave të tyre personale dhe bazën ligjore për ta bërë këtë.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin.

Sipas nenit 5, paragrafi 1, të LMDhP-së, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën, njëri nga kriteret e mëposhtme: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë. Kjo nuk zbatohet për përpunimin e kryer nga autoritetet publike për përmbushjen e detyrave të tyre.

Në bazë të dispozitave ligjore dhe deklaratës së kontrolluesit gjatë inspektimit, konstatohet se kontrolluesi ka të drejtë që, për qëllime të ngritjes së kallëzimit penal, si provë të ofrojë edhe pamjet e mbledhura nga kamerat e vendosura në institucion.

Neni 75, paragrafi 3, i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton se të dhënat e mbledhura nga vëzhgimi me kamerë mund të përpunohen dhe të shfrytëzohen vetëm nëse janë të nevojshme për realizimin e qëllimeve të synuara dhe nëse nuk ekzistojnë indikacione se ato cenojnë interesat legjitime të subjektit të të dhënave. Përdorimi i këtyre të dhënave për qëllime të tjera lejohet vetëm kur është i domosdoshëm për parandalimin e kërcënimeve ndaj shtetit dhe sigurisë publike ose për ndjekjen të veprave penale.

Megjithatë, në rastin konkret, kontrolluesi, me rastin e ofrimit të incizimeve policisë, ka dorëzuar regjistrimet e plota të një dite të tërë, pa ndërmarrë masat e duhura teknike dhe organizative (anonimizimin) ndaj pjesëve që nuk lidhen me çështjen konkrete për të cilën ka pretenduar. Dorëzimi i regjistrimeve të tërë ditës, përfshirë edhe pjesët që nuk kanë lidhje me rastin përbëjnë tejkalim të qëllimit fillestar të përpunimit dhe bie ndesh me parimin e **minimizimit të të dhënave**, i përcaktuar në nenin 4, paragrafi 3, të LMDhP-së, sipas të cilit të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe të kufizuara vetëm në atë masë që është e nevojshme për realizimin e qëllimit për të cilin përpunohen.

Kontrolluesi kishte për detyrim që, para se të dorëzonte incizimet në polici si provë përmes USB-së, të ndërmerre masat teknike dhe organizative duke kufizuar pamjet vetëm në ato segmente kohore që janë të nevojshme për qëllim të hetimit, duke shmangur shpërndarjen e materialeve të panevojshme që përmbajnë të dhëna personale të subjektit të të dhënave që nuk janë relevante për rastin. Prandaj, në këndvështrim të LMDhP-së, bazuar në ankesën e pranuar dhe faktet e konstatuara, vlerësohet se kontrolluesi, me rastin e ofrimit të të dhënave personale tek palët e treta (në këtë rast policia), nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për të garantuar që përpunimi i të dhënave të kryhet në pajtim me nenin 4, paragrafët 1 dhe 3, si dhe nenin 5 të LMDhP-së.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, dhe si e tillë është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi në të ardhmen t'i shmanget sanksioneve të tilla, e rrjedhimisht të përpunojë të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi pas shqyrtimit të ankesës, vërtetimit të gjendjes faktike si dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Mirvete Çallaki Aliu

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Autoriteti i Konkurrencës – kontrollues,
- Ankueses,
- Arkivit të Agjencisë.